



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 02 Prot.

Tiranë, më 11.01.2021

V E N D I M

Nr. 01, datë 11.01.2021

Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e rregullave për trajnimin fillestar për hetimin të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore”

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i mbledhur sot në datën 11.01.2021, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nenin 10 pika “dh” të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”,

V E N D O S I

Miratimin e Rregullores “Për caktimin e rregullave për trajnimin fillestar për hetimin të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore” të këtij Komisioni, në përputhje me tekstin bashkangjitur këtij vendimi. Rregullorja të publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU
mungon

ANËTAR
HARI GOGO



ANËTAR
ARTUR SEJATI

ANËTAR
ALBERT MUÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

RREGULLORE

Nr. 01, Datë 11.09.2021

**PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR TRAJNIMIN FILLESTAR PËR HETIMIN
TË PERSONAVE TË PËRZGJEDHUR SI OFICERË TË POLICISË GJYQËSORE
TË SEKSIONEVE DHE SHËRBIMEVE TË POLICISË GJYQËSORE.**

Në mbështetje të nenit 10, gërma “dh” të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, pasi mori miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Akademisë së Sigurisë.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Miratton këto rregulla:

Për trajnimin fillestar për hetimin të personave të përzgjedhur si oficerë të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në shërbimet policore të tjera dhe në Institucionet shtetërore, të cilave me ligj u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore.

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për Trajnimin fillestar për hetimin, mbështetet në ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 10, gërma “dh”, 27 dhe ligjin Nr. 80/2015, datë 17.9.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për organizimin e trajnimit fillestar që duhet të kryejnë të emëruarit rishtas si oficerë të policisë gjyqësore në Seksionet e Policisë

Gjyqësore të ngritura në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Shërbimet e Policisë Gjyqësore të shërbimeve policore të tjera dhe në Institucionet shtetërore, të cilave me ligj u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore.

Rregullorja përcakton periudhën e trajnimit fillestar dhe vendos rregulla për organizimin e tij, hartimin e programit të trajnimit, mënyrën e realizimit të tij si dhe caktimin e personelit akademik që do angazhohet në realizimin e trajnimit fillestar.

Rregullorja, specifikon rolin dhe detyrat që duhet të përmbushin Komisioni i Policisë Gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme dhe Akademia e Sigurisë në realizimin e procesit të trajnimit fillestar për hetimin, në zbatim të detyrave që Ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, u ngarkon këtyre institucioneve.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Në zbatim të neneve 16 dhe 17 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen për trajnimin fillestar për hetimin të:

1. Oficerëve të policisë gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, që emërohen nga Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas zhvillimit të konkurimit dhe propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Oficerëve të Policisë Gjyqësore të shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore të Institucioneve shtetërore të cilave me ligj u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore, të emëruar në përputhje me dispozitat e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Neni 4

Rregistrimi për trajnimin fillestar për hetimin

1. Pas nxjerjes së aktit administrativ të emërimit nga Komisioni i Policisë Gjyqësore, për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, dhe organi i emërtesës për oficerët e shërbimeve dhe institucioneve të tjera, para se të fillojë ushtrimin e funksioneve, oficeri i policisë gjyqësore i emëruar, kryen trajnimin fillestar për hetimin, parashikuar nga neni 15, 16 dhe 27 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

2. Me marrjen e urdhërit të emërimit, oficeri i policisë gjyqësore regjistrohet në programin e trajnimit fillestar për hetimin dhe njihet me të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë këtij programi.

Neni 5

Qëllimi i trajnimit

Kryerja e trajnimit fillestar për hetimin të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore, të emëruar sipas ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka për qëllim dhe synon:

- a) Të pajisë oficerët e policisë gjyqësore me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të hetuar vepra penale, nën drejtimin e prokurorit.
- b) Tu japë oficerëve të policisë gjyqësore informacion për aftësitë dhe njohuritë që janë të nevojshme për kompetencat kryesore që duhet të ketë një oficerë i policisë gjyqësore i ngarkuar me hetimin e veprave penale.
- c) Të ndërgjegjësojë oficerët e policisë gjyqësore për përgjegjësitë që ata kanë në ushtrimin e funksioneve të tyre;
- d) Të rrisë aftësitë praktike të oficerëve të policisë gjyqësore, e cila do ti ndihmojnë në veprimtarinë e përditshme për hetimin e veprave penale.
- e) Të pajisë oficerët e policisë gjyqësore me metodikat e hetimit për grup veprash penale të ndryshme, me të cilat do të ballafaqohen gjatë ushtrimit të funksionit të oficerit të policisë gjyqësore.
- f) Tu japë oficerëve të policisë gjyqësore njohuritë e nevojshme për provat, mjetet e kërkimit të provave, për rëndësinë dhe ndikimin që ka zbatimi i kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale për mënyrën e marrjes së tyre gjatë hetimit.
- g) Të ndërgjegjësojë oficerët e policisë gjyqësore për qëndrimin e paanshëm, profesional, inegritetin dhe etikën profesionale që ata duhet të shfaqin gjatë ushtrimit të funksionit, duke shmangur çdo konflikt ineresi.
- h) Ndërgjegjësimin e oficerëve të policisë për detyrimin që ata kanë për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të palëve në proçes dhe shtetasve gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 6

Periudha e trajnimit fillestar.

1. Për caktimin e periudhës/afatit gjatë të cilit do të kryhet trajnimi fillestar për hetimin, Komisioni i Policisë Gjyqësore, Prokurori i Përgjithshëm dhe Akademia e Sigurisë, merr në konsideratë qëllimin, synimet dhe objektivat që kërkohet të arrihen nëpërmjet këtij proçesi trajnimi si dhe nivelin, natyrën e arsimimit dhe formimin profesional të kandidatëve të emëruar.
2. Trajnimi fillestar për hetimin përfshinë një periudhë prej **12** javë. Gjatë periudhës së trajnimit fillestar, oficerit të policisë gjyqësore, të emëruar i ofrohet:
 - **program teorik**, i cili synon të pajisë oficerin e policisë gjyqësore me njohuritë e nevojshme në fushën e hetimit të veprave penale
 - **program praktik profesional**, me synim paisjen e tij me aftësi praktike në ushtrimin

e ndjekjes penale.

3. Për oficerët e policisë gjyqësore, të emëruar për të qenë pjesë e Seksioneve të Policisë Gjyqësore të Prokuroritë dhe që kanë arsimin dhe formimin profesional si jurist, periudha e trajnimit fillestar do të jetë **60** ditë, nga të cilat **12** ditë do të jenë trajnim teorik, nëpërmjet dhënies së leksioneve dhe **48** ditë trajnim praktik.
4. Për oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Institucioneve shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, dhe oficerët e policisë gjyqësore të emëruar në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, të cilët kanë arsimin dhe formimin profesional në fusha të tjera, periudha e trajnimit fillestar do të jetë **60** ditë, nga të cilat **24** ditë trajnim teorik dhe **36** ditë trajnim praktik.

Neni 7

Mënyra dhe institucioni i kryerjes së trajnimit fillestar.

1. Programi teorik parashikon dhënien e njohurive teorike (leksione), të ndara në njohuri të përgjithshme, njohuri profesionale dhe njohuri në disiplina të lidhura.
2. Programi teorik dhe dhënia e leksioneve do të zhvillohet pranë Akademisë së Sigurisë. Akademia e Sigurisë ofron infrastrukturën njerëzore dhe materiale për zhvillimin e kursit të trajnimit teorik. Programi teorik dhe dhënia e leksioneve do të zhvillohet **gjatë 12 javëve , në ditën e parë të çdo jave**. E llogaritur në orë, programi teorik do të përfshijë **60** orë leksione, duke parashikuar që një orë të zgjas 50 minuta.
3. Për oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Institucioneve shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, dhe oficerët e policisë gjyqësore të emëruar në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, të cilët kanë arsimin dhe formimin profesional në fusha të tjera, programi teorik dhe dhënia e leksioneve do të zhvillohet **gjatë 12 javëve , në dy ditët e para të çdo jave**.
4. Nëpërmjet leksioneve teorike synohet që të transmetohen te oficerët e policisë gjyqësore njohuri teorike dhe praktike në lidhje me organet proçeduese të përcaktuara sipas fazave të procedimit penal, të akteve procedurjale penale, afatet e kryerjes së hetimeve, të provave dhe aktivitetit provues, metodave të hetimit , të drejtat e palëve në proçesin penal, afatet e përpilimit të akteve procedurjale dhe aftësitë përpiluese të akteve procedurjale dhe aftësitë e arsyetimit ligjor të akteve.
5. Programi praktik profesional do të zhvillohet në një ose disa nga **Prokuroritë e mëdha të vendit**. Programi praktikës profesionale do të zhvillohet gjatë **48** ditëve, **5** ditë në javë. E llogaritur në orë, programi praktikës profesionale do të përfshijë **288** orë gjithsej.
6. Për oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Institucioneve

shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, dhe oficerët e policisë gjyqësore të emëruar ne seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, të cilët kanë arsimin dhe formimin profesional në fusha të tjera, programi praktik profesional do të zhvillohet gjatë 36 ditëve, 3 ditë në javë. E llogaritur në orë, programi praktikës profesionale do të përfshijë 216 orë gjithsej.

7. Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me drejtuesit e Prokurorive, përcakton Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, ku do të zhvillohet trajnimi praktik si dhe prokurorin/prokurorët përgjegjës për periudhën që oficeri i policisë gjyqësore kryen programin praktik profesional .
8. Prokurori/prokurorët përgjegjës për programin profesional, drejton dhe kontrollon veprimtarinë praktike të oficerit të policisë gjyqësore, duke e angazhuar atë në konsulta dhe në ndjekjen aktive të rasteve që janë në hetim si dhe i kërkon atij të asistojë në kryerjen e veprimeve hetimore nga oficerët e policisë gjyqësore të kësaj prokurorie.

Neni 8

Vlerësimi në përfundim të trajnimit teorik

1. Akademia e Sigurisë, nëpërmjet pedagogëve përgjegjës, ndjek përgatitjen teorike të oficerëve të policisë gjyqësore në trajnim, pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet teorike.
2. Në përfundim të trajnimit teorik, pedagogët që kanë dhënë leksionet gjatë trajnimit teorik, i paraqesin Rektorit të Akademisë së Sigurisë / Dekanit të Fakultetit të Hetimit të Krimit, regjistrin me frekuentimin e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe një vlerësim përshkrues për secilin prej tyre.
3. Rektori i Akademisë së Sigurisë / Dekanit të Fakultetit të Hetimit të Krimit, bëjnë vlerësimin përfundimtar të oficerëve të policisë gjyqësore në trajnim, për kryerjen e trajnimit teorik. Vlerësimi përfundimtar bëhet në formën e një vlerësimi përshkrues nëpërmjet një formulari, në të cilin, pasqyrohet frekuentimi dhe angazhimi i oficerit të policisë gjyqësore gjatë trajnimit.
4. Vlerësimi përfundimtar për trajnimin teorik u dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm Drejtuesve të Institucioneve shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore dhe ku oficeri i policisë gjyqësore i trajnuar bënë pjesë si dhe Komisionit të Policisë Gjyqësore.

Neni 9

Vlerësimi në përfundim të trajnimit praktik

1. Drejtuesi i Prokurorisë, nëpërmjet prokurorëve përgjegjës, ndjek veprimtarinë dhe përgatitjen praktike të oficerëve të policisë gjyqësore në trajnim, pjesëmarrjen

e tyre në aktivitetet praktike dhe angazhimin e tyre.

2. Në përfundim të trajnimit praktik, prokurori / prokurorët përgjegjës gjatë trajnimit praktik, i paraqesin Drejtuesit të Prokurorisë, regjistrin me frekuentimin e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe një vlerësim përshkruar për secilin prej tyre.
3. Drejtuesi / Drejtuesit, i Prokurorisë bëjnë vlerësimin përfundimtar të oficerëve të policisë gjyqësore në trajnim, për kryerjen e trajnimit praktik. Vlerësimi përfundimtar bëhet në formën e një vlerësimi përshkruar nëpërmjet një formulari, në të cilin pasqyrohet frekuentimi dhe angazhimi i oficerit të policisë gjyqësore gjatë trajnimit.
4. Vlerësimi përfundimtar për trajnimin praktik u dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesve të Institucioneve shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njuh funksionet e Policisë Gjyqësore dhe oficeri i policisë gjyqësore i trajnuar bënë pjesë si dhe Komisionit të Policisë Gjyqësore.
5. Dokumentet e lëshuara nga Akademia e Sigurisë dhe Drejtuesi i Prokurorisë, të cilat përmbajnë vlerësimin e oficerit të policisë të trajnuar dhe vërtetojnë së oficeri i policisë gjyqësore ka kryer trajnimin fillestar për hetimin, bëhen pjesë e dosjes personale të tij.

Neni 10

Caktimi i ekspertëve trajnues

Akademia e Sigurisë, mbi bazën e temave të përzgjedhura për trajnimin teorik, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore përzgjedhin ekspertët trajnues nga stafi i pedagogëve të Akademisë dhe ekspertë të jashtëm të fushës së kërkuar.

Neni 11

Hartimi i programit të trajnimit fillestar

1. Akademia e Sigurisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj, pasi ka marrë dhe mendimin e Prokurorit të Përgjithshëm, harton programin e trajnimit teorik, temat që do trajtohen, kurrikulat dhe orët e leksioneve.
2. Për trajnimin profesional, Prokurori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Drejtuesit e Prokurorive të caktuara për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, përcakton natyrën e grupve veprave penale për të cilat oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrë njohuri praktike për mënyrën se si zhvillohet hetimi, në të cilin përfshihen, ndërtimi i planit të hetimit, si të marrë në pyetje dëshmitarin, si të hartojë disa akte baze të hetimit, si të ndjek afatet e hetimit dhe mënyrën si të hartojë relacionin për përfundimin e hetimeve.

Neni 12

Detyrat e oficerit të policisë gjyqësore në trajnim fillestar

- Oficeri i Policisë Gjyqësore në trajnim fillestar ka pë detyrë:
- Të frekuenntojë rregullisht orët dhe ditët e planifikuara për trajnimin fillestar.
 - Të jetë aktiv dhe të tregojë angazhim maksimal gjatë trajnimit teorik dhe atij praktik.
 - Të njoftojë me shkrim institucionin ku bënë pjesë për pamundësinë objektive të pjesëmarrjes në trajnim.

Neni 13

Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare për kurset e trajnimit fillestar përballohen nga institucionet që ligji i posaçëm u njeh funksionet e policisë gjyqësore, në raport me numrin e personave që do të trajnojnë. Mënyra e kryerjes së shpenzimeve dhe masa e tyre, sipas tarifave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, do të vendosen me marrëshje të përbashkët të këtyre institucioneve.

Neni 14

Dispozita zbatuese

Për zbatimin e kësaj rregullore ngarkohen, Komisioni i Policisë Gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme, Akademia e Sigurisë dhe Institucionet shtetërore, të cilave, ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORË

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU
Mungon

ANËTAR
ARTUR SEJATI
Mungon

ANËTAR
HARI GOGO
HGOG

ANËTAR
ALBERT MUÇO
MUÇO